

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II-
KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal **Nr. 81**
nga mbledhja publike e mbajtur më **18.9.2007**
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

1. Rifat **KRASNIÇ** kryetar
2. Jusuf **SUTAJ**
3. Shaban **HALIMI**
4. Zyhrie **MALOKU**
5. Berat **LUZHA**
6. Sadudin **BERISHA**
7. Afrim **ARZUALLXHIU**
8. XHelal **CANZIBA**
9. Fetah **BERISHA**
10. Gazmend **MUHAXHERI**
11. Selvije **HALIMI**

Munguan :

12. Lulzim **ZENELI** nënkryetar-I
13. Goran **BOGDANOVIĆ**-nënkryetar-II-
- 14.

TË FTUARIT : nga MMPH (Nazmi Shkodra etj)

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit për Shitjen e Banesave...
3. Të ndryshme.

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

Shqyrtimi i Projektligjit për Shitjen e Banesave

Kryetari Rifat Krasniç në fillim përshëndeti anëtarët e komisionit dhe të ftuarit nga MMPH të cilët filluan të elaborojnë rreth projektligjit në fjalë, mirëpo anëtarët e komisionit ndërprenë këto sqarime nga ata duke kërkuar shpjegime për titullarin dhe blerësin e banesave, ngase si theksoi **Sadudin Berisha** në këtë projekt kemi titullarin (pronarin) dhe shfrytëzuesin e banesës. **Afrim Arzuallxhiu** mori shembull privatizimin e një ndërmarrjeje shoqërore , dhe pyeti se kush është pronar tani i banesave që kanë qenë të kësaj ndërmarrjeje. Disa anëtarë ishin të mendimit se komuna ku ekziston banesa është pronare (**Jusuf Sutaj, Selvije Halimi etj**)

Gazmend Muhaxheri kërkoi që neni 4 të përmirësohet, gjë kjo që është kërkuar në seancën plenare gjatë leximit të parë, që me rastin e shitjes së banesës mos të figuroi fjalia në këtë nen “së bashku me tokën në ndërtesë”.

Kryetari duke konstatuar se kjo çështje e titullarit mbetet e paqartë për komisionit , me pajtimin e komisionit , kërkoi nga zyrtarët e MMPH të qartësojnë këtë dilemë të shfaqur në mbledhjen e sotme dhe të sjellin mendimin profesional për mbledhjen e radhës, kur do të vazhdoi komisioni të shqyrtoi këtë projekt.

Të ndryshme

Kryetari njoftoi komisionin :

1. kryesia me vendim ka kërkuar nga ky komision të hartoi rekomandimet bashkë me komisionin për legjislacion lidhur me ndërtimet ilegale në Mitrovicën veriore. **Selvije Halimi** theksoi se ky komision ka bërë aq sa ka mundur me përgatitjen e ligjit për ndërtimet ilegale, por vërejti se kjo çështje me konotacion politik e ka shtyre kryesinë të kërkoi rekomandime nga këto dy komisione, ndaj propozoi që anëtarët e komisionit secili të lexoi transkriptin nga seanca plenare lidhur me këtë çështje , pastaj në një mbledhje të analizohet kjo çështje deri te ndonjë rekomandim eventual për seancën plenare, me çka edhe komisioni u pajtua.
2. **Berat Luzha** theksoi se situata e prodhuesve individual (bujqve) gjithnjë po bëhet më e vështirë të cilët gjithsesi duhet të stimulohen . Në mënyrë që mos të përjetojmë ditë më të vështira se tani, ai propozoi ti drejtohet komisioni MEF-it e cila me angazhimin e saj do të siguroi që ligji për buxhetin e vitit 2008 të ritet sa i përket MBPZHR me dedikim të stimulimit të prodhuesve individual dhe agrobiznesit. Këtë propozim komisioni e miratoi në formë të përfundimit i cili do ti dërgohet ministrisë në fjalë me shkrim.
3. Lidhur me kërkesën e **Bahri Hazirit** nga Zhabari i Ulët komisioni nuk gjeti rrugë institucionale ose ligjore për ti dalur në ndihmë lidhur me djegëjen e fermës së pulave që ka ndodhur në pronën e tij private.

4. **Kryetari** konstatoi se delegacioni për Maqedoni i cili udhëton nesër në ora 8 në mëngjes, pëson ndryshim për shkak të mosardhjes së dy anëtarëve të caktuar, ndaj këta janë : **Rifat Krasniç, Shaban Halimi, Xhelal Canziba, Selvije Halimi, Berat Luzha dhe Bajram Badivuku.**

(Vërejtje : Administrata është njoftuar nga kryetari i komisionit se komisioni këto tri vizita fillon ti realizoi përkundër faktit se nuk është bërë kërkesa kryesisë, ky formalitet do të bëhet pasi të arrijnë konfirmimet nga këto tri shtete. Kryesia ka miratuar mbajtjen e konferencës rajonale për çka bëhen këto vizita përgatitore.)

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

